

UDHËZIM
Nr. 10, datë 14.5.2026

PËR PROCEDURAT E MARRËVESHJES SË PAQES FISKALE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në zbatim të nenit 10, pika 3 dhe nenit 11, pika 4, të ligjit nr. 84/2025, “Për marrëveshjen e paqes fiskale”, ministri i Financave

UDHËZON:

1. Objekti

Ky udhëzim përcakton procedurat për hartimin dhe përmbajtjen e propozimit të marrëveshjes së paqes fiskale, mënyrat e komunikimit me tatimpaguesin dhe konfirmimin elektronik, regjistrimin dhe ruajtjen e marrëveshjes në regjistrin elektronik tatimor, si dhe trajtimin e rasteve të refuzimit, mospranimit, përfundimit të vlefshmërisë ose pavlefshmërisë së marrëveshjes.

2. Aplikimi nga tatimpaguesi

2.1 Tatimpaguesi që ka dorëzuar deklaratën vjetore të Tatimit mbi të Ardhurat e Korporatës (TAK) ose Tatimit mbi të Ardhurat Personale nga Biznesi (TAPB), i cili gjatë vitit tatimor paraardhës ka realizuar të ardhura bruto mbi 14 milionë lekë, nuk ka përfituar nga ndonjë normë e reduktuar apo përjashtim tjetër tatimor dhe plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 7, të ligjit “Për marrëveshjen e paqes fiskale” (këtu e në vijim “ligji”), aplikon elektronikisht për lidhjen e marrëveshjes së paqes fiskale.

2.2 Aplikimi për marrëveshjen e paqes fiskale duhet të dorëzohet brenda afatit për dorëzimin e deklaratës vjetore të të ardhurave të vitit paraardhës, pra brenda datës 31 mars të vitit për të cilin aplikohet marrëveshja. Për vitin e parë tatimor të zbatimit, pra viti tatimor 2026, afati i aplikimit për lidhjen e marrëveshjes së paqes fiskale dhe nënshkrimi elektronik i saj nga tatimpaguesi përcaktohet me udhëzim/sqaruese të drejtorit të përgjithshëm të tatimeve, i cila do të njoftohet nëpërmjet kanaleve të komunikimit dhe do të publikohet në faqen zyrtare të administratës tatimore.

2.3 Në modulën “Çështjet e mia”, në sistemin *e-Filing* krijohet shërbimi “Aplikim për marrëveshjen e paqes fiskale”. Formulari i aplikimit “Për lidhjen e marrëveshjes së paqes fiskale” pasqyrohet në shtojcën nr. 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

2.4 Pas aplikimit nga tatimpaguesi, në sistemin C@TS krijohet automatikisht një çështje tek rubrika “Çështjet e mia” në sistemin *e-Filing*.

3. Administrimi fillestar i çështjes

3.1 Në rastet kur tatimpaguesi ka detyrime tatimore të papaguara ose të padeklaruara, çështja refuzohet automatikisht, duke dhënë arsyetimin përkatës.

3.2 Në rastet kur tatimpaguesi nuk ka detyrime tatimore të papaguara ose të padeklaruara, çështja i adresohet drejtorit të kontrollit pranë drejtorisë rajonale tatimore (DRT) të juridiksionit ku është i regjistruar tatimpaguesi, për verifikimin për plotësimin e kriterëve të tjera ligjore, sipas nenit 7 të ligjit.

4. Verifikimi i kriterëve ligjore

4.1 Drejtoria e Kontrollit pranë DRT-së përkatëse verifikon nëse tatimpaguesi ka dorëzuar:

a) Vërtetimin e lëshuar nga prokuroria e juridiksionit të përgjithshëm ku është i regjistruar tatimpaguesi, që vërteton se subjekti nuk është në proces procedimi penal për vepra penale në fushën tatimore.

Ky vërtetim paraqitet për personin juridik, administratorët dhe pronarët përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për regjistrin e pronarëve përfitues;

b) Dëshmitë e penaltetit që vërteton se nuk janë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra penale në fushën e tatimeve, pastrimit të produkteve të veprës penale ose fshehjes së të ardhurave, për personin juridik, administratorët dhe pronarët përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për regjistrin e pronarëve përfitues;

c) Vërtetimin nga Drejtoria e Apelimit Tatimor për ankimimet te Drejtoria e Apelimit Tatimor dhe Komisioni i Shqyrtimit të Apelimeve Tatimore, që nuk është në proces ankimimi administrativ;

ç) Vetëdeklarimin e tatimpaguesit që nuk realizon projekte koncesionare;

d) Vetëdeklarimin se në dijeninë e aplikuesit, ai nuk është në dijeni të ekzistencës së procedimeve, sipas germës “a” të këtij neni.

4.2 Në rast të plotësimit kushteve sipas pikës 4.1, Drejtoria e Kontrollit pranë DRT-së, verifikon nëse tatimpaguesi është ose jo subjekt hetimi nga administrata tatimore dhe nëse realizon ose jo projekte koncesionare. Për verifikimet sipas kësaj pike, merren në konsideratë:

a) listat e përcjella paraprakisht nga Drejtoria e Hetimit Tatimor për subjektet nën hetim për të cilat nuk është bërë ende referim pranë organit të prokurorisë; dhe

b) lista e projekteve koncesionare. Lista e projekteve koncesionare kërkohet zyrtarisht nga DPT-ja pranë ministrisë përgjegjëse për ekonominë dhe i shpërndahet DRT-ve.

4.3 Nëse të gjitha kriteret e mësipërme plotësohen, inspektori procedon me hartimin e draftmarrëveshjes.

5. Hartimi i marrëveshjes

5.1 Sistemi gjeneron dokumentin “Marrëveshja e paqes fiskale”, duke përfshirë:

a) fitimin e tatueshëm të vlerësuar, i cili llogaritet duke shtuar me 18% fitimin e tatueshëm të vitit të mëparshëm tatimor për të cilin hartohet marrëveshja;

b) normën tatimore që aplikohet për fitimin e tatueshëm të vlerësuar dhe çdo fitim shtesë;

c) përlllogaritjen mbi bazën vjetore të llogaritjes së kësteve paraprake;

ç) shpërndarjen e kësteve për periudhën e mbetur të vitit tatimor;

d) në rast se tatimpaguesi në formularin e aplikimit të marrëveshjes, ka shprehur se do të kryejë edhe rideklarimin e pasqyrave financiare, Marrëveshja do të ketë të përfshirë edhe të drejtën për rideklarimin e elementeve të veçanta të aktiveve, të detyrimeve apo të kapitaleve të veta të pasqyrave financiare vjetore të shoqërisë, sipas normës së tatimit dhe procedurës së përcaktuar në këtë ligj. Për zbatimin e kësaj pike, tatimpaguesi plotëson dhe dorëzon formularin e aplikimit, sipas shtojcës 2 bashkëlidhur këtij udhëzimi.

6. Nënshkrimi elektronik dhe lidhja e marrëveshjes

6.1 Draftmarrëveshja nënshkruhet dhe vulozet elektronikisht nga titullari i drejtorisë rajonale tatimore të juridiksionit dhe dokumenti i dërgohet tatimpaguesit për nënshkrim elektronik në “*Dokumentat e mia*”, në sistemin *e-Filing*, brenda datës 10 prill të vitit për të cilin lidhet marrëveshja.

6.2 Tatimpaguesi nënshkruan elektronikisht dokumentin dhe e ringarkon në të njëjtën çështje brenda datës 15 prill të vitit për të cilin lidhet marrëveshja.

6.3 Gjatë vlefshmërisë së marrëveshjes së paqes fiskale për përgjegjësitë e Tatimit mbi të Ardhurat të Korporatës dhe Tatimin mbi të Ardhurat Personale nga Biznesi, nuk kryhen kontrole tatimore në kuptim të pikës 80.3 (a), të udhëzimit nr. 24, datë 2.9.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, përveç rasteve kur për tatimpaguesin është regjistruar një çështje hetimore në proces për konsumin e veprës penale të krijimit të skemave mashtruese me

tatimin mbi vlerën e shtuar apo fshehje e të ardhurave, sipas parashikimeve në Kodin Penal. Megjithatë, gjatë vlefshmërisë së marrëveshjes, tatimpaguesit do të vijojnë t'i nënshtrohen vlerësimit periodik nga zyra për qëllime monitorimi, në zbatim të ligjit në fuqi për procedurat tatimore.

6.4 Pas nënshkrimit elektronik të marrëveshjes nga të dyja palët, marrëveshja konsiderohet e lidhur në datën e nënshkrimit elektronik nga tatimpaguesi dhe prodhon efekte ligjore për vitin tatimor përkatës. Aplikuesi i cili në formularin e aplikimit për lidhjen e marrëveshjes së paqes fiskale, sipas shtojcës nr. 1 të këtij udhëzimi, ka deklaruar që do të kryejë rideklarimin e pasqyrave financiare për një ose disa nga vitet tatimore dhe kryen rideklarimin e këtyre pasqyrave financiare, duhet të dorëzojë pranë drejtorisë rajonale tatimore të juridiksionit formularin e aplikimit për rideklarimin e elementeve të veçanta të aktiveve, të detyrimeve apo të kapitaleve të veta të pasqyrave financiare vjetore, sipas shtojcës nr. 2 të këtij udhëzimi, shoqëruar me dokumentacionin bashkëlidhur këtij formulari, brenda datës 30 qershor të vitit kur lidhet Marrëveshja. Aplikimi sipas shtojcës nr. 2, bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe rideklarimi i pasqyrave financiare sipas kësaj pike bëhet vetëm një herë dhe nuk mund të përsëritet apo të korrigjohet. E drejta e rideklarimit të elementeve të veçanta të aktiveve, të detyrimeve apo të kapitaleve të veta të pasqyrave financiare vjetore bëhet vetëm nga subjektet që kanë lidhur marrëveshjen e paqes fiskale.

6.5 Për rideklarimet e elementeve të veçanta të pasqyrave financiare të kryera në përputhje me nenin 6, të ligjit, nuk do të aplikohen dënimet administrative (gjoba, interesa apo kamatëvonesa) të cilat gjenerohen nga sistemi elektronik i tatimeve, sipas legjislacionit në fuqi për procedurat tatimore. Drejtoria rajonale tatimore merr masa për sistemimin e këtyre penaliteteve. Në pikën 2, të shtojcës nr. 3, bashkëlidhur këtij udhëzimi, pasqyrohen shembuj konkretë, për rideklarimin e transaksioneve të veçanta të pasqyrave financiare vjetore.

6.6 Për elementet e veçanta të pasqyrave financiare, të rideklaruara në përputhje me nenin 6, të ligjit, nuk ushtrohet kontroll tatimor, sipas nenit 80, të ligjit “Për procedurat tatimore”, të ndryshuar. Ky përjashtim vlen vetëm për pjesën e elementeve të rideklaruara, në zbatim të nenit 6 të ligjit. Ndërsa, për deklaratat fillestare sipas përgjegjësive tatimore, të cilat në zbatim të nenit 6 të ligjit rideklarohen, administrata tatimore ruan të drejtën për të ushtruar kontroll tatimor të deklaratave fillestare në bazë të analizës së riskut, sipas nenit 80, të ligjit “Për procedurat tatimore”, të ndryshuar.

7. Gjenerimi i shtesës së kësteve paraprake dhe raportimi

7.1 Pas lidhjes së marrëveshjes, sistemi gjeneron shtesën e kësteve paraprake për TAK ose TAPB.

7.2 Gjenerohen këstet paraprake nga Plani i Parapagimeve, si dhe shtesat e bazuara në marrëveshjen e paqes fiskale.

7.3 Për të përlllogaritur efektin e marrëveshjes, krijohet një raport në bazë të kësteve shtesë të gjeneruara, i cili evidenton diferencën midis totalit të planeve të parapagimit të kësteve dhe planeve të mbledhjes së kësteve të gjeneruara në bazë të marrëveshjes.

7.4 Përlllogaritjet përfundimtare të tatimit kryhen në Deklaratën Vjetore Tatimore. Në pikën 1, të shtojcës nr. 3, bashkëlidhur këtij udhëzimi, pasqyrohen shembuj konkretë për llogaritjen e fitimit të tatueshëm të vlerësuar, këstet paraprake dhe TAK ose TAPB të llogaritjet në deklaratën vjetore.

8. Përfundimi i marrëveshjes dhe ndryshimet e kësteve

8.1 Për qëllime të zbatimit të nenit 10, të ligjit, përfundimi i vlefshmërisë së marrëveshjes së paqes fiskale konsiderohet se ndodh në rastet e mëposhtme:

a) tatimpaguesi ndryshon llojin e veprimtarisë së deklaruar në marrëveshje. Ndryshim i llojit të veprimtarisë ekonomike konsiderohet çdo ndryshim i veprimtarisë së ushtruar nga tatimpaguesi që nuk përputhet me veprimtarinë e përcaktuar në marrëveshje.

b) tatimpaguesi nuk realizon rritjen e fitimit të tatueshëm në mbi 18% krahasuar me vitin paraardhës. Mosrealizimi i këtij kriteri vlerësohet në përfundim të vitit tatimor për të cilin është lidhur marrëveshja, bazuar në deklaratën vjetore të TAK apo TAPB;

c) kur tatimpaguesi ka kërkuar pezullimin ose ndërprerjen përfundimtare të aktivitetit ekonomik. Kalimi në statusin pasiv, kërkesa për çregjistrim apo çregjistrimi përfundimtar i veprimtarisë ekonomike sipas të dhënave të regjistruara në QKB;

ç) ka kryer shkelje të përsëritura të detyrimeve tatimore që cenojnë ndershmërinë fiskale. Nëse tatimpaguesi përsërit të paktën dy herë shkelje të lidhura me detyrimet tatimore, si për shembull TVSH-në, kontributet, tatimin në burim dhe të tjera, sipas legjislacionit tatimor në fuqi, atëherë marrëveshja humbet vlefshmërinë në momentin që shkelja ndodh për herë të dytë;

d) mospagimi i detyrimeve sipas marrëveshjes. Mospagim konsiderohet:

i. mosshlyerja, brenda afateve të përcaktuara të kësteve të parapagimeve, TAK apo TAPB. Në rast se edhe për një muaj, tatimpaguesi nuk paguan në afat këstet, marrëveshja konsiderohet e prishur;

ii. në rastet kur tatimpaguesi ka nënshkruar në marrëveshje për të bërë edhe rideklarimin e elementeve të veçanta të aktiveve, të detyrimeve apo të kapitaleve të veta të pasqyrave financiare, të paguajë edhe detyrimet sipas nenit 6 të ligjit;

dh) nuk plotësohen kushtet e nenit 6 të ligjit. Në rast se tatimpaguesi, në aplikimin e tij për Marrëveshjen ka zgjedhur rideklarimin edhe të elementeve të veçanta të aktiveve, të detyrimeve apo të kapitaleve të veta të pasqyrave financiare deri në tri vitet e fundit, mosplotësimi i kushteve sipas ligjit për rideklarimin e elementeve të veçanta të pasqyrave financiare vjetore, cenon marrëveshjen dhe shkakton përfundimin e saj;

e) rritet fitimi i tatueshëm mbi 50% në vitin tatimor për të cilin është lidhur marrëveshja krahasuar me vitin tatimor paraardhës. Rritja e fitimit të tatueshëm mbi 50% vlerësohet në përfundim të vitit tatimor përkatës, duke krahasuar fitimin e deklaruar me atë të vitit tatimor paraardhës. Në këtë rast, aplikohet norma e tatimit prej 15% mbi të gjithë fitimin e tatueshëm.

Për të gjitha rastet më sipër kur prishet marrëveshja, administrata tatimore përlllogarit detyrimin për tatimin mbi fitimin ose tatimin mbi të ardhurat nga biznesi, sipas normave të parashikuara në ligjin “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, mbi të gjithë shumën e fitimit të tatueshëm, bazuar në deklaratën vjetore të TAK apo TAPB.

8.2 Nëse gjatë periudhës nga momenti i lidhjes së marrëveshjes deri më 31 dhjetor të vitit tatimor për të cilin është lidhur marrëveshja, plotësohet ndonjë nga kushtet për përfundimin e saj sipas nenit 10 të ligjit “Për marrëveshjen e paqes fiskale”, Drejtoria e Kontrollit pranë DRT-së përkatëse kryen manualisht ndryshimin e Planit të Kësteve dhe tatimpaguesi humbet përfitimet e parashikuara në ligj.

8.3 Tatimpaguesi humbet përfitimet e parashikuara në ligj, kur:

a) tatimpaguesi ka aplikuar për përfundimin e marrëveshjes, sipas shkronjave “b”, “c” dhe “d”, të nenit 10, të ligjit për marrëveshjen e paqes fiskale;

b) strukturat përkatëse konstatojnë plotësimin e kushteve sipas nenit 10, të ligjit për marrëveshjen e paqes fiskale.

8.4 Në të dyja rastet e mësipërme, pas përfundimit të marrëveshjes, ndryshimi dhe përlllogaritja e kësteve për periudhën e mbetur kryhet manualisht, duke marrë parasysh edhe pagesat e kësteve të kryera sipas marrëveshjes.

8.5 Në rastet kur përfundon marrëveshja si shkak i plotësimit të paktën të njërit nga kushtet e listuara në pikën 1, të nenit 10 të ligjit, dhe ndërkohë tatimpaguesi ka rivlerësuar pasqyrat financiare sipas nenit 6 të ligjit, administrata tatimore kryen kontrollin dhe rivlerësimin e detyrimit tatimor, në përputhje me normat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për tatimin mbi të ardhurat.

9. Regjistrimi dhe ruajtja në regjistrin elektronik

9.1 Marrëveshja regjistrohet në Regjistrin Elektronik Tatimor, me numër unik, datën e lidhjes, të dhënat e tatimpaguesit, llogaritjet dhe historikun e veprimeve, përfshirë edhe dokumentacionin e aplikimit dhe pranimit të tij.

9.2 Dokumentet ruhen në arkivin elektronik për 15 vjet nga momenti i mbylljes së marrëveshjes.

10. Trajtimi i refuzimit, mospranimit ose pavlefshmërisë

10.1 Refuzimi i marrëveshjes së paqes fiskale ndodh në rastet kur, gjatë administrimit fillestar të çështjes ose gjatë verifikimit të kriterëve ligjore, sipas nenit 7 të ligjit dhe pikave 2, 3 dhe 4 të këtij udhëzimi, konstatohet se tatimpaguesi nuk plotëson një ose më shumë nga kushtet ligjore për lidhjen e marrëveshjes.

10.2 Në rast refuzimi, administrata tatimore, përmes sistemit *e-Filing*, i kthen përgjigje tatimpaguesit në çështjen e hapur për aplikimin e marrëveshjes, duke e refuzuar këtë marrëveshje dhe duke ia komunikuar tatimpaguesit arsyen e refuzimit. Refuzimi sjell mbylljen e çështjes dhe marrëveshja nuk lidhet, duke mos prodhuar asnjë efekt juridik për vitin tatimor përkatës.

10.3 Tatimpaguesi, ndaj të cilit është marrë vendim refuzimi, nuk përfiton nga lehtësitë dhe përfitimet e parashikuara në ligjin për marrëveshjen e paqes fiskale për vitin tatimor përkatës, por ka të drejtë të aplikojë sërish për vitet pasuese tatimore, nëse plotëson kushtet ligjore.

10.4 Mospranimi i marrëveshjes konsiderohet kur tatimpaguesi, pas marrjes së draftmarrëveshjes të nënshkruar elektronikisht nga administrata tatimore, nuk e nënshkruan elektronikisht marrëveshjen brenda afatit të përcaktuar në pikën 6.2 të këtij udhëzimi. Në këtë rast, marrëveshja konsiderohet e panënshkruar dhe nuk prodhon efekte juridike.

10.5 Në rast mospranimi të marrëveshjes nga tatimpaguesi, çështja mbyllet automatikisht në sistemin *e-Filing* dhe detyrimet tatimore të tatimpaguesit për vitin tatimor përkatës administrohen dhe përllogariten sipas rregullave të përgjithshme të legjislacionit tatimor në fuqi.

10.6 Pavlefshmëria e marrëveshjes konsiderohet kur, pas lidhjes së saj, rezulton se:

a) marrëveshja është lidhur mbi bazën e të dhënave të pasakta, deklarimeve të rreme ose dokumentacionit të pavërtetë të paraqitur nga tatimpaguesi, në kundërshtim me dispozitat e ligjit për marrëveshjen e paqes fiskale ose të këtij udhëzimi;

b) ndaj tatimpaguesit, administratorit dhe/ose pronarëve përfitues, ka filluar hetim nga Prokuroria e Juridiksionit të Përgjithshëm ose nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, për veprat penale të parashikuara në nenin 4, pika 4.1, shkronja “a” e këtij udhëzimi.

10.7 Në rast pavlefshmërie të marrëveshjes, administrata tatimore kryen rivlerësimin e plotë të detyrimeve tatimore për periudhën përkatëse, në përputhje me legjislacionin tatimor në fuqi, duke përfshirë tatimin e plotë, interesat dhe penaltetet përkatëse, pa u kufizuar nga kushtet dhe përfitimet e parashikuara në marrëveshjen e paqes fiskale.

10.8 Vendimi për refuzimin, mospranimin ose pavlefshmërinë e marrëveshjes regjistrohet pranë Administratës Tatimore dhe i komunikohet tatimpaguesit në mënyrë elektronike, përmes sistemit *e-Filing*.

11. Dispozitë kalimtare

11.1 Për një periudhë kalimtare, deri në mundësimin e aplikimit elektronik për lidhjen e “Marrëveshjes së paqes fiskale”, formulari/ët i/e aplikimit, si dhe dokumentacioni shoqërues, do të paraqitet në formë shkresore, pranë drejtorisë rajonale tatimore të juridiksionit.

11.2 Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve merr masat për njoftimin e tatimpaguesve në momentin e mundësimin të aplikimit në rrugë elektronike.

12. Hyrja në fuqi

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE
Petrit Malaj

SHTOJCA NR. 1

FORMULAR APLIKIMI

PËR LIDHJEN E MARRËVESHJES SË PAQES FISKALE

(Sipas neni 5 të Ligjit nr. 84/2025)

I. TË DHËNAT E TATIMPAGUESIT

- Numër Identifikimi i Tatimpaguesit (NIPT): _____
- Emri i Tatimpaguesit: _____
- Emri tregtar (nëse ka): _____
- Forma ligjore: Person Fizik Shoqëri tregtare/entitet
- Adresa: _____
- E-mail: _____
- Nr. Tel/Mob: _____
- Drejtoria Rajonale e Tatimeve: _____
- Kodi i aktivitetit (NVE): _____

II. VLERËSIMI I FITIMIT TË TATUESHËM

- Viti tatimor: _____
- Lloji i tatimit (zgjidhet vetëm një sipas formës ligjore):
 - Tatim mbi të ardhurat e korporatës
 - Tatim mbi të ardhurat personale nga biznesi

III. RIDEKLARIMI I ELEMENTEVE TË PASQYRAVE FINANCIARE

Referuar pikës 1 te neni 6 të Ligjit nr. 84/2025, deklaroj se:

- **do të kryej rideklarimin e pasqyrave financiare** për periudhat tatimore _____
- **nuk do të kryej rideklarimin e pasqyrave financiare** për periudhat tatimore të mëparshme

*Shënim: Nëse subjekti do të kryejë rideklarimin e pasqyrave financiare, duhet të përcaktojë edhe periudhën tatimore për të cilën do të kryhet ky rideklarim. Periudhat tatimore për të cilat kryhet rideklarimi, nuk mund të jenë më shumë se tre vitet e mëparshme tatimore, _____, _____, _____.

IV. DEKLARATË SIPAS NENIT 7 TË LIGJIT NR. 84/2025

Deklaroj me përgjegjësi ligjore se subjekti:

1. Nuk ka detyrime tatimore të papaguara ose të padeklaruara;
2. Nuk është në proces ankimi administrativ (vërtetim nga Drejtoria e Apelit Tatimor për ankimimet tek Drejtoria e Apelit Tatimor dhe Komisioni i Shqyrtimit të Apelimeve Tatimore);
3. Nuk është subjekt hetimi nga administrata tatimore;
4. Nuk është subjekt i procedimit penal tatimor (vërtetim nga Prokuroria e Juuridiksionit të Përgjithshëm ku është i regjistruar subjekti);
5. Nuk ka vendim penal të formës së prerë për vepra penale në shumën tatimore/pastrim parash (dëshmi penaliteti);
6. Nuk realizon projekte koncesionare.

V. DOKUMENTACIONI BASHKËNGJITUR

Vërtetimet përkatëse sipas nenit 7 të ligjit:

- Vërtetim që nuk është në proces ankimi administrativ - nga Drejtoria e Apelit Tatimor
- Vërtetim që nuk është subjekt hetimi apo procedimi penal tatimor (nga Prokuroria dhe Gjykata e Rrethit)
- Vërtetim që nuk ka vendim penal të formës së prerë për mashtrim tatimor/pastrim parash (dëshmi penaliteti)

Deklaroj se, fitimi i tatueshëm i vitit ushtrimor _____ parashikohet të rritet sipas normave të parashikuara në Ligjin nr. 84/2025 dhe shpreh dakordësinë që Administrata Tatimore të korrigjojë dhe gjenerojë kështu përkatëse në kuadër të marrëveshjes së Paqes Fiskale, sipas referencave të nenit 5 të këtij Ligji.

Aplikuesi/Administratori i shoqërisë

Emër Mbiemër

(Nënshkrimi/Vula)

SHTOJCA NR. 2

FORMULAR APLIKIMI

PËR RIDEKLARIMIN E ELEMENTEVE TË VEÇANTA TË AKTIVEVE, TË DETYRIMEVE APO TË KAPITALEVE TË VETA TË TË PASQYRAVE FINANCIARE

(Sipas neni 6 të Ligjit nr. 84/2025)

I. TË DHËNAT E TATIMPAGUESIT

- Numër Identifikimi i Tatimpaguesit (NIPT): _____
- Emri i Tatimpaguesit: _____
- Emri tregtar (nëse ka): _____
- Forma ligjore: Person Fizik Shoqëri tregtare/entitet
- Adresa: _____
- E-mail: _____
- Nr. Tel/Mob: _____
- Drejtoria Rajonale e Tatimeve: _____
- Kodi i aktivitetit (NVE): _____

II. RIDEKLARIMI I ELEMENTEVE TË PASQYRAVE FINANCIARE

Në aplikimin e kryer për marrëveshjen e paqes fiskale sipas ligjit 84/2025, referuar pikës 1 të nenit 6 të Ligjit nr. 84/2025 **kam deklaruar që do të kryej rideklarimin e elementeve të veçanta të aktiveve, të detyrimeve apo të kapitaleve të veta të pasqyrave financiare.**

Ky aplikim është miratuar me nr. _____ Prot., datë _____, dhe referuar nenit 6 të Ligjit nr. 84/2025, deklaroj se, kam konstatuar pasaktësi në pasqyrat financiare të periudhës/ave tatimore _____ dhe paraqes kërkesën për vijimin e procedurës së rideklarimit të tyre, duke pranuar pagesën e tatimit në masën 5%.

	Zëri që rideklorohet	Gjendja e Llogarisë sipas pasqyrës së dorëzuar	Gjendja e Llogarisë sipas Rideklarimit	AKTIV Shtesa/Pakësimi	PASIV Shtesa / Pakësimi	Tatimi për t'u paguar
A	Aktive monetare					
A	Aktive të tjera financiare afatshkurtra/					

A	Fshirja e aktiveve afatgjata materiale/ jo materiale					
A	Deklarim i aktiveve afatgjata materiale/ jo materiale të pa përfshirane PF					
P	Fshirja e Detyrimeve/Borxheve					
P	Rideklarim i fitimit të mbartur të shoqërisë dhe shpërndarja si dividend/fitim i tij					
	Shuma					

III. DOKUMENTACIONI BASHKËNGJITUR

1. Pasqyrat financiare të rideklaruara;
2. Deklarata tatimore e ndryshuar për secilin vit tatimor ndryshohet si më poshtë:
 - a) Për deklaratat e vitit 2023 dhe 2024, vendoset shuma totale e ridekluar në rubrikën (18) “Fitimi i tatueshëm neto” dhe shuma e tatimit për t’u paguar duke plotësuar rubrikën (21) “Tatim fitimi me përqindje të tjera”;
 - b) Për deklaratën e vitit 2025 e në vijim, vendoset të dhënat në rubrikat (48/49) “Tatimi mbi të ardhurat e korporatës me shkallë tatimore të tjera”, konkretisht vendoset shuma totale e ridekluar në rubrikën (48) “Baza e tatueshme”, dhe shuma e tatimit për t’u paguar vendoset në rubrikën (49) “Tatimi”.
3. Pagesa e tatimit të kryer për çdo vit tatimor për të cilin është ndryshuar deklarata tatimore, brenda datës 30 qershor të vitit kur është lidhur marrëveshja.

Aplikuesi/Administratori i shoqërisë

Emër Mbiemër

(Nënshkrimi/Vula)

SHTOJCA NR. 3

1. SHEMBUJ PËR LLOGARITJEN E FITIMIT TË TATUESHËM TË VLERËSUAR, KËSTET PARAPRAKE PER TAK OSE TAPB:

Shembulli nr.1: <i>Subjekti “xxx shpk.”, entitet, subjekt i TAK-es, gjatë vitit 2026 ka patur të ardhura bruto prej 30,000,000 lekë, ndërkohë fitimi i tatueshëm i realizuar për këtë periudhë ka qenë 2,800,000 lekë.</i>	
<ul style="list-style-type: none"><i>Për vitin 2027 subjekti, i cili plotëson të gjitha kriteret sipas ligjit “Për marrëveshjen e paqes fiskale”, pasi ka dorëzuar deklaratën TAK 2026, aplikon brenda datës 31 mars 2027 për lidhjen e marrëveshjes së paqes fiskale.</i><i>Administrata tatimore, pas administrimit të kërkesës së tatimpaguesit, dhe verifikimit të kriterëve ligjore, mbi bazën e formulës së vlerësimit, harton dhe i propozon tatimpaguesit vlerën e paracaktuar të fitimit të tatueshëm, që do përdoret për llogaritjen e detyrimit tatimor gjatë periudhës së marrëveshjes, normën tatimore, si dhe për llogaritjen e kësteve paraprake dhe shpërndarjen e kësteve për periudhën e mbetur të vitit tatimor.</i>	
1. Sa do të jetë fitimi i tatueshëm i vlerësuar për të cilin do të nënshkruhet marrëveshja?	<ul style="list-style-type: none">Fitimi i tatueshëm i vlerësuar në marrëveshje = Fitimi i vitit paraardhës për të cilin lidhet marrëveshja + 18%* e Fitimit të vitit paraardhës.2,800,000 lekë + 18%*2,800,000 lekë = 3,304,000 lekë Pra marrëveshja me tatimpaguesin “xxx shpk.”, për vitin tatimor 2026, do të nënshkruhet për fitimin e tatueshëm prej 3,304,000 lekë.
2. Cila do të jetë norma që do të aplikohet për fitimin e tatueshëm të vlerësuar në marrëveshje?	<ul style="list-style-type: none">Për tatimpaguesit të cilët janë pjesë e fushës së zbatimit të këtij ligji, në bazë të nenit 41, të ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, norma tatimore është 15% e fitimit të tatueshëm.Për sa më lart, në marrëveshje do të përcaktohet se norma tatimore për fitimin e tatueshëm të vlerësuar prej 3,304,000 lekë është 15%, dhe se për çdo fitim shtesë mbi vlerën 3,304,000 lekë për vitin tatimor 2027, do të paguhet 5%.
3. Sa do të jenë këstet e tatimit mbi të ardhurat e korporatës që do të paguajë tatimpaguesi dhe si do të bëhet shpërndarja e kësteve për periudhën e mbetur të vitit tatimor?	<ul style="list-style-type: none">Totali i vlerës së kësteve paraprake për t’u paguar do të jetë 3,304,000 lekë * 15% = 495,600 lekë.Shpërndarja e kësteve do të kryhet në Planin e Parapagimit, për periudhën Prill 2027 – Mars 2028, sipas nenit 63 të Ligjit nr.29/2023 “Të tatimit mbi të ardhurat”, mbi bazën e re të rivlerësuar dhe do të jenë në total 12 këste paraprake.
4. Nëse në deklaratën vjetore të TAK rezulton se tatimpaguesi për vitin 2027	<ul style="list-style-type: none">Duke qenë se tatimpaguesi realizon një rritje të fitimit të tatueshëm me 28,6% [(3,600,000 lekë – 2,800,000 lekë)/2,800,000 lekë], pra fitimi i tatueshëm për vitin 2027

<p>ka një fitim të tatueshëm prej 3,600,000 lekë, sa është tatimi i llogaritur i tatimpaguesit për vitin 2027?</p>	<p>është mbi 18% dhe deri në 50%, dhe kushtet e tjera për përfundimin e marrëveshjes nuk janë cënuar, atëherë vijohet me llogaritjen e tatimit mbi fitimin.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Në rastin konkret norma tatimore do të jetë: <ul style="list-style-type: none"> a) Për fitimin e tatueshëm deri në 3,304,000 lekë, subjekti do të paguajë normën standarde tatimore prej 15% të përcaktuar në Marrëveshje, dhe b) Për çdo fitim shtesë mbi shumën 3,304,000 lekë, subjekti do të paguajë normën 5%. • Tatimi mbi të ardhurat e Korporates (TAK), i llogaritur për tatimpaguesin për vitin tatimor 2027 është: $= 15\% * 3,304,000 \text{ lekë} + 5\% * (3,600,000 \text{ lekë} - 3,304,000 \text{ lekë})$ $= \mathbf{510,400 \text{ lekë}} \text{ tatim.}$ <p>Kjo shumë duhet të rezultojë e paguar brenda datës 31.03.2028.</p>
<p>Shembulli nr. 2:</p> <p>Subjekti “A.B.”, person fizik i vetëpunësuar, në deklaratën e të ardhurave personale nga biznesi TAPB-së, për vitin 2026, ka deklaruar të ardhura bruto nga biznesi prej 21,524,000 lekë, ndërkohë fitimi i tatueshëm i realizuar për këtë periudhë ka qenë 2,460,000 lekë.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Për vitin 2027 subjekti, i cili plotëson të gjitha kriteret sipas ligjit “Për Marrëveshjen e Paqes Fiskale”, pasi ka dorëzuar deklaratën TAPB, aplikon brenda datës 31 Mars 2027 për lidhjen e marrëveshjes së paqes fiskale. • Administrata tatimore, pas administrimit të kërkesës së tatimpaguesit, dhe verifikimit të kriterëve ligjore, mbi bazën e formulës së vlerësimit, harton dhe i propozon tatimpaguesit vlerën e paracaktuar të fitimit të tatueshëm, që do përdoret për llogaritjen e detyrimit tatimor gjatë periudhës së marrëveshjes, normën tatimore, si dhe përllogaritjen e kësteve paraprake dhe shpërndarjen e kësteve për periudhën e mbetur të vitit tatimor. 	
<p>1. Sa do të jetë fitimi i tatueshëm i vlerësuar për të cilin do të nënshkruhet marrëveshja?</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Fitimi i tatueshëm i vlerësuar në marrëveshje = Fitimi i vitit paraardhës për të cilin lidhet marrëveshja + 18%* e Fitimit të vitit paraardhës. • $2,460,000 \text{ lekë} + 18\% * 2,460,000 \text{ lekë} = 2,902,800 \text{ lekë}$ Pra marrëveshja me tatimpaguesin “A.B.”, për vitin tatimor 2027, do të nënshkruhet për fitimin e tatueshëm prej 2,902,800 lekë.

<p>2. Cila do të jetë norma që do të aplikohet për fitimin e tatueshëm të vlerësuar në marrëveshje?</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Bazuar në pikën 2, të nenin nr. 24, të ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, norma tatimore që aplikohet mbi fitimin e tatueshëm për personin fizik të vetëpunësuar objekt i këtij ligji, është progresive, konkretisht: <ul style="list-style-type: none"> - 15% për fitimin e tatueshëm deri në 14 milionë lekë, dhe - 23% për pjesën e fitimit të tatueshëm mbi 14 milionë lekë. • Personi fizik i vetëpunësuar, ka një fitim të tatueshëm të vlerësuar prej 2,902,800 lekë, pra më pak se 14 milionë lekë. Në këtë rast, për fitimin e tatueshëm të vlerësuar në marrëveshje, do të aplikohet vetëm norma standarde 15%. • Përsa më lart, në marrëveshje përcaktohet se norma tatimore për fitimin e tatueshëm të vlerësuar prej 2,902,800 lekë është 15%, dhe se për çdo fitim shtesë mbi vlerën 2,902,800 lekë do të paguhet tatim në masën 5% me dorëzimin e deklaratës tatimore të vitit 2027, brenda datës 31 mars 2028.
<p>3. Sa do të jenë këstet e tatimit mbi të ardhurat personale nga biznesi që do të paguajë tatimpaguesi dhe si do të bëhet shpërndarja e kësteve për periudhën e mbetur të vitit tatimor?</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Totali i vlerës së kësteve paraprake për t’u paguar do të jetë: $2,902,800 \text{ lekë} * 15\% = 435,420 \text{ lekë}$. 2. Shpërndarja e kësteve do të kryhen në Planin e Parapagimit, për periudhën Prill 2027 – Mars 2028, sipas nenit 63 të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, mbi bazën e re të rivlerësuar dhe do të jenë në total 12 këste paraprake.
<p>4. Nëse në deklaratën vjetore të TAPB rezulton se tatimpaguesi për vitin 2026 ka një fitim të tatueshëm prej 3,250,000 lekë, sa është tatimi i llogaritur i tatimpaguesit për vitin 2027?</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Duke qenë se tatimpaguesi realizon një rritje të fitimit të tatueshëm me 32,1% [$(3,250,000 \text{ lekë} - 2,460,000 \text{ lekë}) / 2,460,000 \text{ lekë}$], pra fitimi i tatueshëm për vitin 2027 është mbi 18% dhe deri në 50%, dhe kushtet e tjera për përfundimin e marrëveshjes nuk janë cënuar, atëherë vijohet me llogaritjen e tatimit mbi fitimin. • Norma tatimore sipas nivelit të të ardhurave do të jetë: <ol style="list-style-type: none"> a) Për fitimin e tatueshëm deri në 2,902,800 lekë subjekti do të paguajë normën tatimore prej 15% të përcaktuar në Marrëveshje, dhe b) Për çdo fitim shtesë mbi shumën 2,902,800,000 lekë subjekti do të paguajë normën 5%. • Tatimi mbi të ardhurat personale nga biznesi i llogaritur për tatimpaguesin për vitin tatimor 2027 është: $= 15\% * 2,902,800 \text{ lekë} + 5\% * (3,250,000 \text{ lekë} - 2,902,800 \text{ lekë})$ $= 452,780 \text{ lekë tatim}$ <p>Kjo shumë duhet të rezultojë e paguar brenda datës 31.03.2028.</p>

2. SHEMBUJ PËR RIDEKLARIMIN E ELEMENTETE VEÇANTË TË PASQYRAVE FINANCIARE VJETORE

Bazuar në pikën 2 të Nenit 6 të Ligjit Nr. 84/2025” Për Marrëveshjen e Paqes Fiskale” çdo element i rideklaruar në pasqyrat financiare mund të jete i ndryshuar deri në masën 30% dhe duhet të japë efekt neto në rritje në të ardhura apo kapital.

Shembulli 1:

Viti		2024				
	Zëri që rideklarohet	Gjendja e Llogarisë sipas pasqyrës së dorëzuar	Gjendja e Llogarisë sipas Rideklarimit	AKTIV Shtesa / Pakësimi	PASIV Shtesa / Pakësimi	Tatimi për t'u paguar
A	Aktive monetare	100.000	130.000	30.000		1,500
A	Aktive të tjera financiare afatshkurtra/					-
A	Fshirja e aktiveve afatgjata materiale/jo materiale					-
A	Deklarim i aktiveve afatgjata materiale/jo materiale					-
P	Fshirja e Detyrimeve/Borxheve					-
P	Rideklarim i fitimit të mbartur të shoqërisë dhe shpërndarja si dividend/fitim i tij				30.000	1,500
	Shuma			30.000	30.000	3,000

Subjekti “A” rivlerëson vetëm zërin Aktive monetare, të cilin e ndryshon me rritje prej 30.000 lekë, nga 100.000 leke në 130.000 lekë dhe ky ndryshim plotëson kushtin deri në 30% nga deklarimi fillestar. Për këtë ndryshim/shtesë paguan tatim 5% të vlerës ose 1.500 lekë.

Efekti neto në rritjen e të ardhurave apo kapitalit është 30.000 lekë dhe duhet të paguajë 5% të vlerës ose 1.500 lekë.

Në total Subjekti “A” duhet të paguajë 3.000 lekë (1.500 lekë për ndryshimin e zërit Aktive monetare +1.500 lekë për ndryshimin e zërit Rideklarim i fitimit të mbartur të shoqërisë).

Totali i tatimit të llogaritur pas rivlerësimit duhet paguar nëpërmjet ndryshimit të Deklaratës vjetore të Tatimit mbi Fitimin të vitit që i përket ndryshimi, pra e vitit 2024, duke plotësuar rubrikën (21) Tatim fitimi me përqindje të tjera.

Shembulli 2- I përgjithshëm.

Viti 2023

	Zëri që rideklarohet	Gjendja e Llogarisë sipas pasqyrës së dorëzuar	Gjendja e Llogarisë sipas Rideklarimit	AKTIV Shtesa / Pakësimi	PASIV Shtesa / Pakësimi	Tatimi për t'u paguar
A	Aktive monetare	100.000	130.000	30.000		1,500
A	Aktive të tjera financiare afatshkurtra/	200.000	140.000	-60.000		3.000
A	Fshirja e aktiveve afatgjata materiale/jo materiale	200.000	140.000	-60.000		3.000
A	Deklarim i aktiveve afatgjata materiale/jo materiale të papërfshira ne PF	100.000	130.000	30.000		1.500
P	Fshirja e Detyrimeve/Borxheve	500.000	350.000		-150.000	7.500
P	Rideklarim i fitimit të mbartur të shoqërisë dhe shpërndarja si dividend/fitim i tij				90.000	4.500
	Shuma			-60.000	-60.000	21.000

Subjekti B:

- Rivlerëson zërin Aktive monetare të cilin e ndryshon me rritje prej 30.000 lekë, nga 100.000 lekë në 130.000 lekë dhe ky ndryshim plotëson kushtin deri në 30% nga deklarimi fillestar. Për këtë ndryshim/shtesë paguan tatim 5% të vlerës ose 1.500 lekë.
- Rivlerëson zërin Aktive të tjera financiare afatshkurtra të cilin e ndryshon me ulje prej 60.000 leke, nga 200.000 leke në 140.000 leke dhe ky ndryshim plotëson kushtin deri në 30% nga deklarimi fillestar. Për këtë ndryshim/pakësim paguan tatim 5% të vlerës ose 3.000 lekë.
- Rivlerëson zërin Aktive afatgjata materiale/jo materiale me ulje prej 60.000 leke, nga 200.000 në 140.000 leke dhe ky ndryshim plotëson kushtin deri në 30% nga deklarimi fillestar. Për këtë ndryshim/pakësim paguan tatim 5% të vlerës ose 3.000 lekë.
- Rivlerëson zërin Aktive afatgjata materiale/jo materiale të papërfshira në pasqyrat financiare me rritje prej 30.000 lekë, nga 200.000 lekë në 140.000 lekë dhe ky ndryshim plotëson kushtin deri në 30% nga deklarimi fillestar. Për këtë ndryshim/shtesë paguan tatim 5% të vlerës ose 3.000 lekë.
- Fshin detyrime të parregullta/borxhe në masën 150.000 lekë, nga 500.000 lekë në 350.000 leke dhe ky ndryshim plotëson kushtin deri në 30% nga deklarimi fillestar. Për këtë ndryshim/pakësim paguan tatim 5% të vlerës ose 7.500 lekë.

Efekti neto në rritjen e të ardhurave apo kapitalit është 90.000 lekë dhe paguan 5% të vlerës ose 4.500 lekë.

Në total Subjekti B duhet të paguajë tatim 21.000 lekë (1.500 lekë për ndryshimin e zërit Aktive monetare +3.000 lekë për ndryshimin e zërit Aktive të tjera financiare afatshkurtra +3.000 lekë për ndryshimin e zërit Aktive afatgjata materiale/ jo materiale +1.500 lekë për ndryshimin e zërit Aktive afatgjata materiale/ jo materiale të papërfshira në pasqyrat financiare +7.500 lekë për fshirjen detyrime të parregullta/borxhe +4.500 leke efektin neto në rritjen e të ardhurave apo kapitalit).

Vlera prej 90.000 lekë e zërit rideklarim i fitimit të mbartur të shoqërisë dhe shpërndarja si dividend/fitim i tij, bazuar në pikën 4 të nenit 6 të ligjit, mund të përdoret lirisht prej tyre për qëllime të biznesit apo personale, pasi të jetë sistemuar edhe pagesa e tatimit.

Totali i tatimit të llogaritur pas rivlerësimit duhet paguar nëpërmjet ndryshimit të Deklaratës vjetore të Tatimit mbi Fitimin të vitit që përket ndryshimi, pra në këtë rast në deklaraten për vitin tatimor 2023, duke plotësuar rubrikën (21) Tatim fitimi me përqindje të tjera.